



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.0.1-2014-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikrat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Kuvendit të Kosovës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Emine Fazliu, e mbështetur nga Ilir Abazi (Udhëheqës Ekipi) dhe Shemsije Llugiqi (anëtare).

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	10
4 Qeverisja.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	21
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	24
Shtojca III: Përgjigja e menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it.....	25


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRRK) për vitin 2014 - i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 24.11.2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:




Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (SNISA 200/1700 - Opinion i Pamodifikuar).

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Menaxhmentit - auditimi 2014

Të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport janë marrë në konsideratë nga Menaxhmenti i KRK-së. Përgjigjet lidhur me çështjet për të cilat nuk kemi mundur të pajtohemi janë dhënë në Aneksin III.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës (KRRK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarrë nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien në mënyrë efikase të produkteve operative cilësore. Për sistemet individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin funksionojnë kontrollet aktuale. Shembull i një aktiviteti mund të jetë monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operative. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Për këtë nevojitet një vlerësim i strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklarata kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Pasqyrat Vjetore Financiare kanë përmbushur kërkesat e Raportimit Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Ndërsa obligimet tjera të raportimit të jashtëm që nuk ndërlidhen me PVF-të nuk ishin përmbushur plotësisht te raportimi i obligimeve dhe te përmbajtja e raportit vjetor për kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik.

2.1 Opinioni i Auditimit

Pasqyrat financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (SNISA 200/1700 - Opinioni i Pamodifikuar).

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

Raportimi financiar duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/ 2013 për PVF-të e organizatave buxhetore;
- Pajtueshmërinë me SNKSP dhe kërkesat tjera të kornizës së raportimit;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat buxhetore;
- Raportet tremujore, përfshirë raportin financiar nëntëmujor;
- Planin vjetor të prokurimit dhe raportin vjetor për kontratat e nënshkuara; dhe
- Raportin vjetor të vetë-vlerësimit të organizatës.

PVF-të janë përgatitur në gjuhët, formatin dhe kohën e duhur dhe se janë nënshkruar nga menaxhmenti, dhe se të njëjtat janë përgatitur në pajtim me kornizën raportuese.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë.

Në kontekst të kërkesave tjera të raportimit të jashtëm, është identifikuar se në Raportin Vjetor për Kontratat e Nënshkuara Publike, i dërguar në KRPP, nuk ishte prezantuar kontrata në vlerë 119,000€. Gjithashtu në raport ishin përfshirë edhe shpenzimet që nuk kishin kaluar përmes procedurave të prokurimit.

Rekomandimi 1 - Prioritet i mesëm - Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se raporti i kontratave publike, që dorëzohet në KRPP, të përfshijë të gjitha kontratat vjetore të realizuara përmes procedurave të prokurimit.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i KRK-së ka ndërmarrë veprime dhe ka adresuar shumicën e çështjeve të ngritura në raportin e auditimit të vitit 2013. Vëmendje e shtuar duhet ti kushtohet çështjeve të ndërlidhura me investimet kapitale, përfshirë kontraktimin dhe implementimin e kontratave.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2013 ka rezultuar me pesë rekomandime. KRK kishte përgatitur një plan veprimi dhe se ka adresuar rekomandimet, me përjashtim të rekomandimit lidhur me realizimin e buxhetit për investime kapitale. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 2 - Mos implementim i rekomandimit të vitit paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Rekomandimi lidhur me investimet kapitale nuk është implementuar. As gjysma e buxhetit të kësaj kategorie nuk është realizuar deri në fund të vitit. |
| Rreziku | Mos realizimi me kohë i projekteve të planifikuara vështirëson dhe redukton efektivitetin e planit vjetor të organizatës. |
| Rekomandimi 2 | Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë qartazi afatet kohore dhe veprimet praktike që duhet ndërmarrë nga stafi përgjegjës në zbatimin e rekomandimit. |

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar si në vijim nga KRK:

- Vetëvlerësimi – është kryer në përputhje me rregullat e MFK-së, duke shërbyer si një pikënisje për të përmirësuar performancën aty ku shihet e nevojshme;
- Menaxhimi i rrezikut – KRK kanë aplikuar procedurë formale për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve operationale në nivel të organizatës;
- Raportimi i menaxhmentit – raportimi është bërë në baza të rregullta, në të cilat është diskutuar për çështjet e aktiviteteve operative të organizatës; dhe
- Auditimi i Brendshëm – Plani i NjAB-it ishte bazuar në shkallën e rrezikut për aktivitetet dhe proceset e përfshira nën auditim. Përmes raporteve të auditimit, menaxhmenti është informuar rreth dobësive dhe efikasitetit të kontrolleve të vendosura.

KRK ka krijuar linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësit. Menaxhmenti komunikon dhe është i informuar për zhvillimet e brendshme. Hartohen raporte të rregullta në nivel të drejtorive, të cilat në formë të konsoliduar përcillen tek menaxhmenti. Menaxhmenti ka ndërmarr një sërë veprimesh për të siguruar se sistemi i kontrollit të brendshëm, raportimi dhe menaxhimi financiar po funksionojnë si duhet. Në përgjithësi kontrollet janë të dizajnuara mirë, zbatohen dhe veprojnë në mënyrën e duhur. Ndërkohë që mekanizmat e kontrollit janë në përgjithësi efikase, përmirësimet veçanërisht janë të nevojshme në menaxhimin e procedurave të prokurimit, menaxhimin e projekteve kapitale dhe menaxhimin e pasurisë.

4.1 Qeverisja e mirë

Përshkrim

Menaxhmenti ka bërë një vlerësim të strukturave, proceseve, kontrolleve dhe linjave të llogaridhënies. Kjo është ndërmarrë si kërkesë e procedurave të MFK-së për vet-vlerësimin vjetor të organizatës. KRK ka zbatuar një numër kontrollesh që përfshijnë menaxhimin financiar dhe organizimin e aktiviteteve operationale. Me gjithë progresin e arritur, mangësi është hasur në ndarjen e detyrave.

Çështja 3 – Ndarje jo e duhur e detyrave – Prioriteti i mesëm

- E gjetura** Testimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm tregon për delegim dhe ndarje jo të duhur të detyrave. Anëtar i komisionit vlerësues të tenderëve ishte caktuar zyrtari që kishte përgatitur specifikacionet e dosjes së tenderit.
- Rreziku** Delegimi jo i duhur i përgjegjësive redukton kontrollin efektiv dhe aftësin e menaxhmentit për të monitoruar në mënyrë aktive aktivitetet e përzgjedhjes dhe menaxhimit të kontratave.
- Rekomandimi 3** Sekretari i Përgjithshëm duhet ta bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive. Detyrat dhe funksionet të cilat bien ndesh nga ushtrimi i tyre nga i njëjti zyrtar të ndahen në pajtim me praktikat, kërkesat dhe rregullativen në fuqi.

4.2 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimin e fondit buxhetor për KRK-në dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,388,157	8,014,195	6,470,018	17,307,643	16,492,680
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,388,157	8,014,195	6,470,018	17,301,343	16,474,020
Donacionet e jashtme	-	-	-	6,300	18,660

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,373,962€. Ndryshimet buxhetore janë bërë bazuar në vendimet e Qeverisë.

KRK ka realizuar 81% të buxhetit final ose 6,470,018€, me një rënie prej 16% krahasuar me vitin 2013. Prej faktorëve që ka ndikuar në mos realizim të buxhetit është reduktimi i shpenzimeve nga mos funksionimi i Parlamentit për gjashtë muaj dhe mos realizimi i disa projekteve nga plani vjetor i prokurimit. Rastet e shpeshta të anulimit të aktiviteteve të prokurimit dhe ankesat e ofertuesve në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) kanë vonuar implementimin me kohë të kontratave, duke reflektuar kështu në aspektin buxhetor. Poashtu, përkundër vendimit të

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave.

Qeverisë nr. 07/172 për shkurtime buxhetore për 15% për mallra e shërbime dhe komunal, teprica buxhetore e këtyre dy kategorive prap del të jetë 395,566€.

Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,388,157	8,014,195	6,470,018	17,307,642	16,492,680
Pagat dhe Mëditjet	6,556,332	5,534,723	4,932,397	5,101,873	5,314,910
Mallrat dhe Shërbimet	1,550,825	1,318,201	966,860	1,563,205	1,384,208
Shërbimet komunale	221,000	187,850	143,626	183,972	176,393
Subvencionet dhe Transferet	30,000	30,000	6,800	9,820,900	8,924,999
Investimet Kapitale	1,030,000	943,421	420,336	637,692	692,170

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti i pagave dhe mëditjeve është nënshpenzuar dhe është zvogëluar për 1,021,609€, si rezultat i ngërçit politik pas zgjedhor dhe mos angazhimit të deputetëve në Kuvend;
- Bazuar në vendimin e qeverisë nr. 07/172 për kursime buxhetore prej 15%, buxheti i mallrave dhe shërbimeve është zvogëluar për 232,624€, ndërsa buxheti për komunal për 33,150€; dhe
- Buxheti i investimeve kapitale ishte zvogëluar për 86,579€ ngase nuk ishte realizuar sipas planit të rrjedhës së parasë.

Çështja 4 - Mos realizim i buxhetit në nivelin e planifikuar - Prioritet i lartë

E gjetura KRK nuk ka arritë të realizojë 19% të buxhetit të përgjithshëm Varianca më e theksuar paraqitet te investimet kapitale ku përkundër reduktimeve buxhetore për 86,579€, niveli i realizimit prap është i ulët.

Rreziku Mos realizimi i buxhetit mund të vështirësojë arritjen e objektivave të synuara të organizatës, me ndikim në reduktimin e efikasitetit të aktiviteteve financiare dhe operative.

Rekomandimi 4 Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se bëhet një vlerësim sistematik i arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit, me fokus të veçantë për investimet kapitale dhe të përcaktojë opsione praktike për avancim të ekzekutimit buxhetor para përcaktimit të programit kapital të vitit 2015.

4.3 Shpenzimet

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Në vitin 2014 KRK ka nënshkruar 48 kontrata publike. Përmes procedurave të hapura ishin zhvilluar 22 prokurime, përmes kuotimit të çmimeve 11 prokurime, dhe me vlerë minimale 15 prokurime. Në mungesë të Operatorëve Ekonomik (OE) të mjaftueshëm dhe të ofertave të përgjegjshme gjatë vitit ishin anuluar 23 aktivitete të prokurimit, ku disa prej tyre ishin anuluar nga dy deri tre herë. Si pasojë e anulimeve të procedurave të prokurimit, ne identifikuan se pesë kontrata të skaduara ishin vazhduar për disa muaj deri në kontraktimet e reja. Në mars të vitit 2015 KRK kishte bërë marrëveshje me Autoritetin Qendror të Prokurimit (AQP) për të shfrytëzuar kontratat për furnizim me derivate dhe bileta të udhëtimit.

Gjithashtu, KRK nuk kishte kontratë publike për shërbimet e telefonisë mobile. Shfrytëzimi i shërbimeve telefonike² bëhej me parapagim (kartela). Në fillim të vitit 2015, KRK ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP), që shërbimet telefonike të kontraktuara në mes MAP dhe PTK-së të shfrytëzohen edhe nga KRK.

Janë disa aspekte të këtyre proceseve mbi të cilat kontrollet nuk janë aplikuar në mënyrë efektive. Aktivitetet e prokurimit nuk janë zhvilluar gjithmonë në përputhje të plotë me kërkesat dhe rregullat e prokurimit publik. Ne testuam 11 procedura të prokurimit publik dhe 54 pagesa në vlerë totale 594,469€. Ne nuk audituam lëndët të cilat ishin në procedurë shqyrtimi nga autoritetet kompetente. Të gjeturat tona janë shpalosur në vijim.

Çështja 5 – Lëndë jo komplete – Prioritet i lartë

E gjetura KRK paguante çdo muaj nga 400€ për mirëmbajtjen mujore të software-it³ për buxhet e financa. Pagesat ishin bërë në mënyrë lineare për çdo muaj. Për mostrën e testuar, përveç një konfirmimi për pagesën e punëve të kryera, ne nuk gjetëm dëshmi të detajuara rreth shërbimeve të mirëmbajtjes së software-it por as kërkesat nga ana e KRK për mbështetje teknike të programit. Edhe kushtet e implementimit të kontratës ishin të paqarta dhe jo të definuar mirë. Me kontratë ishte përcaktuar se *çmimi për muaj do të jetë 400€, ndërsa në paragrafin tjetër thuhet, citojmë: "kontrata e bazuar në vizita parasheh kompensimin në bazë të vizitave që stafi teknik bënë sipas kërkesës sonë, për vizita më të shkurta do të faturohet vetëm gjysmë ditë pune"*.

² Limitet e shpenzimeve mujore për secilin nivel të përgjegjësisë bazohen në shumat e përcaktuara me vendim të Kryesisë së Kuvendit.

³ Ky program i financave/kontabilitetit ishte blerë para disa viteve, dhe që nga ajo kohë KRK paguante mirëmbajtje mujore të këtij programi. Edhe këtë vit ishte nënshkruar kontrata e re për të njëjtin qëllim.

Rreziku Mungesa e dëshmive nuk siguron se shërbimet e ofruara janë në përputhje me kërkesat kontraktuale.

Rekomandimi 5 Sekretari i Përgjithshëm duhet të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë arsyeshmërinë dhe nevojën e një kontrate për mirëmbajtje të softuerit. Përndryshe, kushtet e kontratës duhet të jenë subjekt i rishikimit dhe të përcaktohet qartë forma dhe mënyra e shërbimeve të mirëmbajtjes.

Çështja 6 - Vlerësim jo i drejtë i tenderëve dhe vonesë në realizim të kontratës - Prioritet i lartë

E gjetura Në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Montimi i shkallëve emergjente në Kuvendin e Kosovës” në vlerë 19,360€, ishte kërkuar, përveç tjerash, që ofertuesit të kenë së paku 10 punëtorë të dëshmuar me kontrata pune. Fituesi i kontratës kishte ofruar dëshmi/kontrata pune vetëm për gjashtë punëtor. Kjo ishte një prej arsyeve kryesore për vonesat në realizim të projektit për të cilat KKK-së kishte penalizuar OE.

Rreziku Anashkalimi i kriterit për numrin e kërkuar të punëtorëve rrezikon përzgjedhjen e ofertuesit të papërgjegjshëm. Mungesa e stafit të nevojshëm dhe profesional rrezikon implementimin me kohë të projektit.

Rekomandimi 6 Sekretari i Përgjithshëm duhet të rishikojë kontrollet ekzistuese për të siguruar se komisionet vlerësuese marrin parasysh vetëm ofertuesit që përmbushin kriteret e kërkuara.

Çështja 7 - Mangësi në procedurat e prokurimit - Prioritet i mesëm

E gjetura Disa kontrolle nuk janë zbatuar me konsistencë në proceset e prokurimeve dhe kanë rezultuar me një sërë dobësish të përbashkëta, të cilat janë përshkruar në vijim:

- Te kontratat “Modernizimi dhe Pajisja me Teknologji Digjitale për Sallën Plenare” në vlerë 138,853€ dhe “Furnizim me Pajisje Digjitale Komplet për Sallë Konferenciale C203” me vlerë 40,998€, fituesi i kontratës kishte sjellur kopje të autorizimit të prodhuesit. Dëshmit ishin noterizuar nga kopja e jo nga dokumenti origjinal. Me DT-së, ishte kërkuar që ofertuesit të sjellin autorizimin nga prodhuesi për shitje dhe garancion në formë origjinale ose të noterizuar;
- Sigurimi i ekzekutimit për kontratën kornizë “Furnizim me material elektrik dhe material për gjenerator” ishte bërë në vlerë prej 162€, duke marrë për bazë shumën e çmimeve për njësi 1,624€, e jo në vlerën e planifikuar të kontrates. Sigurimi i ekzekutimit duhej të ishte 1,600€;

- Te kontrata për “Furnizim me dy automjete për nevojat e KRK-së” në vlerë 29,974€, sigurimi i ekzekutimit nuk kishte mbuluar edhe periudhën valide prej 30 ditësh pas kompletimit të kontratës. Automjetet ishin pranuar pas skadimit të afatit të sigurisë së ekzekutimit;
- Në dy kontrata nuk ishte aplikuar Plani i Menaxhimit të Kontratës (PMK), dhe as nuk ishin caktuar menaxherët e kontratave. Ndërsa në dy raste caktimi i menaxherëve të kontratës por edhe përgatitja dhe nënshkrimi i PMK-ve ishin bërë një muaj pas nënshkrimit të kontratës; dhe
- Pesë urdhërblere ishin përgatitur dhe nënshkruar pas pranimi të mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku

Dështimi për të ndjekur me konsistencë procedurat e prokurimit dhe udhëzuesit përkatës e ekspozon organizatën para rrezikut që kontratat të mos implementohen në kohën dhe sipas kushteve të kontraktuara. Mos definimi i qartë i formës dhe përmbajtjes së kriterëve që duhet të përmbushen nga OE ka shkaktuar anulim dhe vonesa në kontraktimin e furnizimeve dhe shërbimeve.

Rekomandimi 7

Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se procedurat dhe kërkesat ligjore zbatohen gjatë gjithë kohës duke filluar që nga procesi i planifikimit të nevojave dhe zotimit të mjeteve, kontraktimi e deri te monitorimi i implementimit të kontratave. Arsyet dhe shkaktarët që kanë ndikuar në anulimin e shpeshtë të aktiviteteve të prokurimit të analizohen, dhe se rezultatet e analizave të merren parasysh në proceset e ardhshme të prokurimit.

4.3.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Përshkrim

Shpenzimet jo përmes prokurimit janë ato shpenzime realizimi i të cilave për shkak të natyrës së tyre nuk kërkon aplikimin e procedurave të prokurimit. Nga ky grup i shpenzimeve ne kemi testuar shpenzimet e telefonisë fikse dhe shpenzimet e udhëtimeve zyrtare. Auditimi ynë konfirmon se këto shpenzime ishin realizuar dhe kalkuluar në pajtim me limitet dhe tarifatat e përcaktuara me rregullat përkatëse, vendimet e kryesisë së Kuvendit dhe politikat e brendshme të organizatës.

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.3.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Personeli i KRK-së përbëhet nga deputetet e Kuvendit, personeli i administratës dhe stafi mbështetës politik i deputeteve dhe grupeve parlamentare. Shpenzimet vjetore të pagave dhe mëditjeve ishin 4,932,397€ nga 5,534,723€ sa ishin në dispozicion. Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të menaxhuar nga MAP. Përveç pagave bazë, të punësuarit e administratës dhe stafi mbështetës politik përfitojnë edhe kompenzime shtesë të rregulluara me akte të veçanta të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Objekt i auditimit në këtë fushë ishin pagat dhe kompensimet shtesë, rekrutimet dhe dosjet e personelit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.3.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

KRK kishte ndarë 6,800€ subvencione nga 30,000€ të buxhetuara. Përfitues të subvencioneve ishin entitetet jo publike. Shpërndarja e subvencioneve bëhej me vendim dhe aprovim të kryetarit të kryesisë së Kuvendit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi ndonjë rekomandim për këtë fushë.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

KRK ka evidentuar tërë pasurinë kapitale në regjistrin kontabël të thesarit. Sipas këtij regjistri vlera neto e pasurisë është 6,799,226€. Pasuria jokapitale dhe materiali shpenzues menaxhohet përmes programit e-pasuria, si dhe përmes një regjistri në formatin excel.

Të dhënat mbi pasuritë kërkojnë azhurnim të mëtejshëm me qëllim që të sigurohet një regjistër i plotë. KRK nuk kishte hartuar rregulla apo procedura të brendshme për menaxhim të pasurisë.

Çështja 8 – Mangësi në regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë – Prioritet i lartë

E gjetura	Rezultatet e auditimit në këtë fushë kanë treguar se: <ul style="list-style-type: none">• Në programin e-pasuria nuk ishin regjistruar pasuritë e blera para vitit 2011. Këto pasuri ishin regjistruar në një databazë tjetër në formatin excel. Vlera e pasurisë sipas këtyre dy databazave ishte e pa harmonizuar, me një ndryshim prej 178,778€. Ndërsa për pasurinë jokapitale të blerë në vitin 2014 nuk ishte llogaritur zhvlerësimi vjetor. Mangësi janë hasur edhe në raportimin e materialit shpenzues;• Numërimi fizik i pasurisë nga komisioni i inventarizimit ishte bërë duke marrë për bazë raportin e inventarizimit të vitit të kaluar, e jo regjistrin e azhurnuar të pasurisë së organizatës; dhe• Listë ngarkesat e punëtorëve për pasuritë me të cilat disponojnë nuk ishin të plota dhe të sakta. Raportet individuale të të punësuarve të përgatitura nga komisioni i inventarizimit dallonin nga regjistri i pasurisë.
Rreziku	Mangësit e hasura vështirësojnë vlerësimin dhe menaxhimin adekuat të pasurisë. Informatat financiare ekzistuese nuk përmbushin plotësisht kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.
Rekomandimi 8	Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha procedurat dhe kërkesat ligjore zbatohen me rastin e regjistrimit, menaxhimit dhe njehësimit fizik të pasurisë.

4.4.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Sipas PVF-ve vlera e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2014 ishte 31,767€. Këto borxhe ndërlidhen me shpenzimet e muajit dhjetor, dhe se natyra e tyre ka të bëjnë me mallra e shërbime dhe shpenzime komunale. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Çështja 9 - Mos raportimi i obligimeve në MF/Thesar - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Shërbimet e bëra për “Modernizimin dhe pajisjen me teknologji digjitale të sallës së Kuvendit” në vlerë 34,650€ nuk ishin paguar brenda afatit ligjor dhe as raportuar⁴ si obligim i papaguar në MF/Thesar.
- Rreziku** Mos pagesa me kohë e detyrimeve mund të sjellë paqartësi ndaj obligimeve dhe konteste të mundshme gjyqësore që mund të rezultojnë më ndëshkime. Si pasojë, mund të shpenzohen fonde me tepër se kundërvlera e shërbimeve dhe mallrave të blera. Mos raportimi i obligimeve i pamundëson MF/Thesarit dhe palëve tjera të interesit të kenë informacionin e duhur rreth obligimeve financiare të organizatës.
- Rekomandimi 9** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se obligimet ndaj furnitorëve paguhen brenda 30 ditëve nga pranimi i faturës. Nëse për çfardo arsye detyrimet ngelin të papaguara, ato duhet të raportohen brenda afatit ligjor në MF/Thesar.

⁴ Rregulla financiare nr. 02/2013/MF i obligon OB që të raportojnë në MF/Thesar për çdo muaj obligimet e papaguara.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Auditimi i Brendshëm (AB) është pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm të organizatës. Për shkak të rëndësisë së tij, ne kemi marrë parasysh aktivitetet dhe fushëveprimin e punës së AB-së dhe Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne kemi shqyrtuar edhe veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm.

KRK ka në funksion Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe Komitetin e Auditimit (KA). NjAB ka përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor të auditimit. Plani i auditimit ishte bazuar në shkallën e nivelit të rrezikut për aktivitetet dhe proceset të përfshira nën auditim. AB kishte përmbushur në tërësi programin vjetor të auditimit, duke realizuar katër⁵ auditimet të planifikuara. Përmes raporteve të auditimit menaxhmentit i janë ofruar informata rreth dobësive të identifikuara dhe vlerësime për funksionimin dhe efikasitetin e kontroleve të vendosura. AB gjithashtu kishte bërë një vlerësim të zbatimit të rekomandimeve të dhëna paraprakisht përmes raporteve të brendshme të auditimit. Çështjet e ngritura nga raportet e auditimit të brendshëm ishin vlerësuar dhe trajtuar edhe nga Komiteti i Auditimit (KA).

⁵ Fokus i auditimit ishin menaxhimi i prokurimit, menaxhimi i buxhetit dhe pagesave, menaxhimi i personelit dhe menaxhimi i pasurisë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të PVF-ve mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3. Adresimi i Rekomandimeve.	Komiteti i Auditimit shqyrton planet, rezultatet dhe monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të ZAP dhe AB.	Është adresuar rekomandimi.		
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Të bëhet një vlerësim i arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale.			Nuk është adresuar rekomandimi.
4.3.1 Prokurimi	Të sigurohet se paraprakisht zotohen fondet buxhetore për projektet kapitale.	Është adresuar rekomandimi.		
4.3.1 Prokurimi	Të shtohen kontrollet për të siguruar se nënkontraktimet të bëhen vetëm pas autorizimit nga ana e KRK-së.	Është adresuar rekomandimi.		
4.5 Auditimi i Brendshëm	KA të kryen përgjegjësit e caktuara në përputhje me udhëzimin administrativ, dhe të mbajë së paku katër takime në vit, dhe se trajton rekomandimet e ZAP dhe AB-së.	Është adresuar rekomandimi.		

Shtojca III: Përgjigja e menaxhmentit ndaj të gjeturave të ZAP-it

Te gjeturat	Pajtohemi po/jo	Komentet nga KRK në rast të mospajtitimit	Pikëpamja e ZAP-it
Çështja 1:	x	<i>Në Raportin e Kontratave të nënshkruara për vitin 2014, i cili ishte dorëzuar në KRPP, nuk është prezantuar vetëm një kontratë (gabim teknik), për një lëndë e cila kishte nisur në vitin 2013, ndërsa kontrata ishte nënshkruar në fillim të vitit 2014. Në raport janë përfshirë edhe shpenzimet që nuk kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit, duke pasur parasysh se Drejtoria e Prokurimit i ka bërë urdhërblertet për këto shpenzime. Urdhërblertja në një formë e ka kuptimin edhe të kontratës.</i>	Edhe komenti i KRK konfirmon të gjeturën tonë. Mbetet i pandryshuar vlerësimi i ZAP-it.
Çështja 3:	x	<i>Në këtë rast për lëndën Modernizimi dhe pajisja me teknologji digjitale - Furnizimi me pajisje digjitale komplet për sallë konferenciale C203, zyrtari kërkesën e ka bërë në emër të Drejtorisë për Teknologji Informativë, por në specifikim teknik nuk shkruan askund se ai ka përgatitur këto specifikime teknike dhe as nuk janë nënshkruar ato nga ai.</i>	Përshkrimi i specifikacionit teknik për blerje është nënshkruar nga zyrtari i cili ishte anëtar i komisionit vlerësues. Mbetet e pandryshuar e gjetura.
Çështja 5:	x	<i>Çështja për të cilën theksohet në Daft Raport ka të bëjë me kontratën e nënshkruar në vitin 2012 kontratë afatgjatë 2012-2014, procedure e hapur. Edhe me atë kontratë nuk është paguar asnjëherë më shumë se totali i paraparë për një muaj që ka qenë: 400 euro. Kontrata e re me titull MIRËMBAJTJA MUJORE E SOFTUERIT PËR BUXHET DHE FINANCA TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, me numër të prokurimit KU101 14 045 236, e nënshkruar në vitin 2014, i ka të qarta specifikimet teknike në Dosje të Tenderit, në bazë të të cilave operatori ekonomik duhet ta përmbushë kontratën.</i>	KRK nuk ka ofruar dëshmi të detajuar për punën e kryer nga OE. Mungesa e dëshmive rreth punës së bërë është evidentuar edhe në raportin e auditimit të brendshëm të KRK-së. Mbetet e pandryshuar e gjetura.

		<p>Moduli i softuare-it për punë me sistemin e drejtorisë së Buxhetit dhe Financave kërkon mirëmbajtje të vazhdueshme si dhe rifreskime me module të reja dhe rikonfigurime.</p> <p>Rregullimi dhe lehtësimi i mbarëvajtjes së punëve në Buxhet dhe Financa, krijimi i dokumenteve dhe raporteve në mënyre automatike, mbajtja e regjistrit dhe evidencës së çdo lëvizje në sistem, krijimi i pasqyrave të ndryshme financiare sipas kërkesës, krijimi dhe lidhja me sistemin e E-Parlamentit të modulit për listën e pagave për punonjës (për çdo punonjës veç e veç me qasje individuale) etj.</p> <p>Mirëmbajtja mundëson funksionimin e vazhdueshëm të sistemit dhe ka rëndësi shumë të madhe.</p> <p>Softueri është i punuar në platformën Microsoft</p> <p>Çmimi i shërbimeve me këtë kontratë për një muaj është: 290 euro.</p>	
<p>Çështja 6:</p>	<p>x</p>	<p>Për këtë aktivitet të Prokurimit, komisioni vlerësues, e ka vlerësuar operatorin ekonomik të përgjegjshëm, pasi që operatori ekonomik e ka ofruar një dokument zyrtar nga ATK, në të cilin shihet se operatori ekonomik i ka 10 punëtorë për të cilët ka paguar kontributet në ATK. (pavarësisht se për disa prej tyre nuk ka dorëzuar kontrata)</p> <p>Drejtorja e Prokurimit në konsultim edhe me Institucionet tjera si, KRPP, por edhe duke u bazuar në Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik, neni 23.6 “OE mundet të lejohet të tregojë aftësi teknike/profesionale përmes çfarëdo dokumenti tjetër nga ato që AK kërkon nëse OE ofron arsye valide dhe AK i konsideron adekuate.” është pajtuar me vlerësimin e Komisionit të vlerësimit, sepse pagesa e kontributeve në ATK për atë periudhë nënkupton se këta punëtorë ishin të rregullt dhe se operatori ekonomik e kishte kapacitetin e duhur në bazë të kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktues.</p> <p>Vonesat në implementim kanë dalë si rezultat i punëve në terren, për të cilat organi mbikëqyrës ka dhënë arsyetimin, ndërsa për vonesat të cilat nuk janë arsyetuar është vepruar në pajtim me LPP duke e penalizuar operatorin ekonomik.</p>	<p>Fituesi i tenderit ka ofruar një dokument se do të angazhojë 6 punëtor për kryerjen e punimeve sipas këtij tenderi. Me DT është kërkuar që OE të ketë së paku 10 punëtor. Mbetet e pandyshuar e gjetura.</p>

<p>Çështja 7:</p>	<p>x</p>	<p><i>Operatori ka sjellë një dokument të noterizuar ashtu siç kemi kërkuar ne. Është përgjegjësi e noterëve të bëjnë noterizimin e dokumenteve në pajtim me Ligjin.</i></p> <p><i>Fjala është për dy kontrata të nënshkruara në vitin 2011, atëherë kur KRPP nuk kishte përgatitur ndonjë formë konkrete rreth Menaxhimit të kontratave.</i></p> <p><i>Ndërsa emërimi me vonesë i menaxherëve është bërë për shkak se gjatë muajve të verës shumica e zyrtarëve kanë qenë në pushime dhe ka qenë vështirë të gjenden zyrtarë kompetent (me aftësi adekuate për kontratën e ckatuar) të cilët në atë kohë kanë qenë në punë. Menaxherët megjithatë janë emëruar para fillimit të ekzekutimit të kontratave.</i></p> <p><i>Ka disa raste kur shërbimet ose furnizimet janë më të komplikuar, si furnizimi me naftë, furnizimi me bileta apo ndonjë kontratë tjetër dhe urdhërblerja nuk mund të bëhet me saktësi para kryerjes së shërbimit ose furnizimit. Urdhërblerjet janë bërë dhe bëhen para ose më së voni në datën e protokolimit të faturave në protokolimin zyrtar të Kuvendit.</i></p>	<p>Pika 1. Me DT është kërkuar autorizimi origjinal ose i noterizuar. Fituesi i tenderit ka sjellur autorizimet e noterizuara nga kopja. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p> <p>Pika 2: Edhe KRK e konfirmon se për ato kontrat nuk kishte Plan të Menaxhimit. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p> <p>Pika 3: Edhe KRK e konfirmon se caktimi i menaxherëve të kontratës është bërë me vonesë. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p> <p>Pika 4: Bazuar në mostrat e testuara dihej sasia apo vlera e furnizimeve. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p>
<p>Çështja 8:</p>		<p><i>Për pasuritë e blera para vitit 2011 nuk na është ofruar përkrahje për të rexhistruar në sistemin e-pasuria, por ne kemi rexhistrin e përgjithshëm të pasurisë në të cilin janë të evidentuara të gjitha pasuritë e Kuvendit.</i></p> <p><i>Pavarësisht asaj se nga cili raport është bërë numërimi fizik (inventarizimi), Komisioni ka evidentuar gjendjen momentale të pasurive në secilin vend.</i></p>	<p>Pika 1: KRK konfirmon mangësit në regjistrimin e pasurisë në e-pasuri. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p>

		<p>Raportet individuale të të punësuarve të përgatitura nga komisioni i inventarizimit dallonin nga regjistri i pasurisë, shkakun që pas pranimit të raportit të Komisionit të inventarizimit, azhurnohet rexhistri i përgjithshëm i pasurisë dhe se kjo nuk ka mundur të bëhet deri në momentin e dorëzimit të Pasqyrave vjetore Financiare.</p>	<p>Pika 2: Inventarizimi i pasurisë është bërë duke mos pasur në disponim raportin e azhurnuar të pasurisë. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p> <p>Pika 3: KRK konfirmon të gjeturën tonë.</p>
<p>Çështja 10:</p>	<p>x</p>	<p>Për lëndën “Modernizimi dhe pajisja me teknologji digjitale – Softuerike në Kuvendin e Republikës së Kosovës” me numër të prokurimit KKSP 13 048 11, është vonuar pagesa e parë për këto arsye:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Operatori ekonomik fitues e ka selinë në Lubjanë dhe ka kërkuar që pagesat t’i bëhen direkt atje me transfer. Pas pranimit të faturës së protokoluar më 10.07.2014, zyrtari i cili bën urdhërblertjet ka pasur problem për të bërë urdhërblertjen në sistem. • Zyrtari i Kuvendit ka kërkuar ndihmë nga Ministria e Financave – Thesari, se si ta realizojë urdhërblertjen në sistem. Duke pasur parasysh se ka qenë kohë e pushimeve verore, kjo ndihmë (shpjegimi) është vonuar. • Po ashtu duke pasur parasysh se ishte kohë e pushimeve është vonuar edhe konfirmimi nga komisioni për pranim teknik të përkohshëm i cili është bërë më datën 03.09.2014. <p>Mund të konstatojmë se pagesat tjera për këtë lëndë janë kryer me kohë dhe nuk ka pasur</p>	<p>Përshkrimi i bërë nga KRK konfirmon vonesën në pagesën e obligimeve ndaj furnitorit. Mbetet e pandryshuar e gjetura.</p>